



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:965/25, Datë:01.08.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Manualin për standardet e doktorates, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 140 të mbajtur më 24.07.2025, mori:

V E N D I M

I. Akreditohet programi i studimeve i Universitetit të Prishtinës – Fakulteti i Mjekësisë për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):

1. Stomatologji, PhD (180 ECTS) me kuotën maksimumi 5 studentë për vit akademik.

II. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.

III. Obligohet Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Mjekësisë që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

IV. Obligohet Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Mjekësisë të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim vetëm nga KShC.

V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Mjekësisë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Stomatologji, PhD (180 ECTS)</i>	Miranda Stavileci Albena Reshitaj Violeta Vula Mergime Prekazi Jehona Reçica Ahmedi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës – Fakulteti i Mjekësisë.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; *Stomatologji, PhD (180 ECTS)*, vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit është organizuar më 17.06.2025.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit ka konstatuar se ky program është vlerësuar se i përmbush të gjitha fushat e standardeve themelore 36/36 dhe 12 nga 16 fushat e standardeve suplementare të përcaktuara me Manualin e standardeve të doktoratës.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 140-të, të mbajtur më datë 24.07.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit të Prishtinës – Fakulteti i Mjekësisë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës-Fakulteti i Mjekësisë ;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

